DATA EQUALITY

Buletini i pestë



Sjellja në terren e gjetjeve të DATA EQUALITY

Midis qershorit dhe korrikut të vitit 2026, Gjykata e Apelit e Venecias dhe Agenfor International organizuan dhe zhvilluan tre trajnime kasakdë në të gjithë Italinë, duke përfshirë gjithsej 298 pjesëmarrës (zyrtarë publikë, profesionistë të fushës së ligjit, profesionistë të sistemit gjyqësor dhe forca të rendit) mbi ndërveprimin e Inteligjencës Artificiale (IA), "data governance" dhe të drejtave themelore.

1. Kuadri Rregullator Digjital Evropian

29 qershor 2026 | Online dhe në Bolonja | 106 pjesëmarrës

E organizuar në bashkëpunim me ANCI-n, ky sesion hapës analizoi peizazhin rregullator të BE-së për teknologjitë digjitale, si Akti për Inteligjencën Artificiale (AI Act), GDPR, Akti për Shërbimet Digjitale dhe legjislacioni për të drejtat e autorit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përgjegjësive që lidhen me përdorimin e IA-së në kontekste që prekin të drejtat themelore dhe parandalimin policor.

2. Anshmëria në Sistemet e IA-së

30 qershor 2026 | Online dhe Venecia | 97 pjesëmarrës

Sesioni i dytë ju drejtua praktikuesve të sistemit të drejtësisë, duke shqyrtuar se si vendimmarrja e mbështetur nga IA mund të sjellë anshmëri dhe diskriminim.

Duke u mbështetur në gjetjet e vetë projektit, diskutimet përfshinë masat mbrojtëse procedurale dhe data governance, duke theksuar se si legjislacioni i BE-së mund të orientojë një përdorim të përgjegjshëm të IA-së, të bazuar në respektimin e të drejtave, në mjediset gjyqësore dhe publike.





3. Diskriminimi në lidhje me të dhënat dhe bashkëpunimi gjyqësor evropian

14 korrik 2026 | Online dhe Romë | 95 pjesëmarrës

Trajnimi përmbyllës trajtoi një nga gjetjet kryesore të projektit DATA EQUALITY: Si të dhënat e fragmentuara ose jo të plota minojnë bashkëpunimin gjyqësor evropian.
Pjesëmarrësit shqyrtuan ndikimin në praktikë mbi Vendimet Kuadër 2008/909/JHA, 2008/947/JHA dhe 2009/829/JHA, si dhe domethënien e këtyre vendimeve mbi aksesin në drejtësi dhe njohjen reciproke.
Sesioni prezantoi gjithashtu rezultatet e Ushtrimit Kombëtar Italian dhe rekomandimet operacionale, ndërsa u mbyll me një demonstrim të drejtpërdrejtë të platformës dixhitale dhe mjeteve të Inteligjencës Artificiale të Agenfor-it.
Tre trajnime, një qëllim i përbashkët: pajisja e praktikuesve në të gjithë Italinë me njohuritë e nevojshme për të menaxhuar në mënyrë të përgjegjshme IA-në dhe qeverisjen e të dhënave, si dhe vendosjen në zbatim të gjetjeve të projektit.



DATA EQUALITY

KONSORCIUMI

CORTE DI APPELLO DI VENEZIA, Italy
FONDAZIONE AGENFOR INTERNATIONAL, Italy
AYUNTAMIENTO DE MURCIA, Spain
FUNDACION EUROARABE DE ALTOS ESTUDIOS, Spain
KENTRO MERIMNAS OIKOGENEIAS KAI PAIDIOU, Greece
HELLENIC POLICE, Greece
Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Albania
Associazione Nazionale Comuni Italiani Emilia Romagna, Italy
Polizia Locale di Milano , Italy
KENTRO MELETON ASFALEIAS, Greece

ΑΚΟΛΟΥΘΗΣΤΕ ΜΑΣ

Facebook:
Data Equality

LinkedIn:
Data Equality

X:
@DataEquality_eu

Co-funded by the European Union

The content of this newsletter represents the views of the author only and is his/her sole responsibility. The European Commission does not accept any responsibility for the use that may be made of the information it contains.